



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri

FJALA E KRYETARIT TË PREZENCËS NË KONFERENCËN “PËRPPJEKJET E PËRBASHKËTA PËR TË LUFTUAR TRAFIKIMIN E QENIEVE NJERËZORE NË SHQIPËRI”

17 qershor 2021

Jam i nderuar që marr pjesë në hapjen e konferencës së sotme për të diskutuar “Përppjekjet e përbashkëta për të luftuar trafikimin e qenieve njerëzore në Shqipëri”, ndaj më lejoni ta nis duke falënderuar Përfaqësuesin e Posaçëm dhe Bashkërenduesin e OSBE-së për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, Valiant Richey-n, për organizimin, bashkërisht, të kësaj veprimtarie. Më lejoni të falënderoj Ambasadoren Shëtitëse kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore nga Suedia, shtet i cili ka Kryesinë e OSBE-së këtë vit, SH.S. Anna Ekstedt, që është bashkuar me ne sot për të ndarë përvojën e gjerë që Stokholmi ka në këtë fushë. Prania juaj, kolegë të nderuar, dëshmon nivelin e mbështetjes që Vjena u jep Misioneve të OSBE-së dhe Shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së në këtë rrugëtim të rëndësishëm. I shpreh mirënjohjen time zonjës zëvendësministre të Brendshme, Romina Kuko, e cila është partnere afatgjatë e Prezencës në Shqipëri dhe që do të flasë këtë mëngjes për arritjet e Qeverisë shqiptare kundër trafikimit të qenieve njerëzore. Ju falënderoj të gjithëve për pjesëmarrja juaj aktive, e cila pasqyron në mënyrë të përkryer përparësinë që të gjithë kemi për luftimin e trafikimit të njerëzve. Në fakt, ndryshimi nuk arrihet me punën e vetëm njërit institucion dhe kjo dëshmohej edhe nga vetë larmia e folësve të mbledhur sot këtu.

Më lejoni të huazoj një frazë franceze dobiplotë për të orientuar diskutimin tonë: “L’ autre me regarde” – “Tjetri i ka sytë nga unë”. Është frazë me kuptim të dyfishtë: tjetri i ka sytë nga unë; po më kërkon ndihmë, (il me regarde) dhe “tjetri ka rëndësi për mua” (il me concerne). Dhe ky është pikërisht thelbi i ushtrimit të sotëm për Trafikimin e Qenieve Njerëzore. Së bashku, do të diskutojmë konceptin e përgjegjësisë, duke tejkalluar idenë statike të thjeshtë njohjes së këtyre krimeve si të tilla. A nuk janë të ndërlidhura me njëra-tjetrën ligjshmëria dhe etika? Bëhet fjalë për atë vijë që nis nga koncepti i lirisë vetjake dhe përfundon me solidaritetin dhe marrjen e përgjegjësisë për tjetrin.

Më lejoni t’ju tërheq vëmendjen në tri pika kryesore:

1. Trafikimi i qenieve njerëzore është plagë e globit.

Është më keq se krim dhe përbën kërcënim sistematik – siç Jamille Bigio dhe Rachel Vogelstein, të dy nga Këshilli i Marrëdhënieve të Jashtme, shkruanin në mënyrë të shkëlqyer në një artikull të botuar vetëm pak ditë më parë. Pavarësisht marrëveshjes shënjuese të vitit 2000, pra Protokollit të Palermos për Parandalimin, Frenimin dhe Ndëshkimin e Trafikimit të personave, kjo murtajë vijon - dhe përllogaritet se 25 milion persona në të gjithë botën janë viktima të punës së detyruar dhe shfrytëzimit seksual. Pjesa më e madhe e viktimave janë gra dhe fëmijë. Trafikimi i qenieve njerëzore ushqehet nga pabarazia shoqërore dhe ekonomike, nga varfëria, papunësia, dhuna dhe konflikti. Përparimi i teknologjisë së informacionit dhe të komunikimit në fakt e lehtëson. Si problem ndërkombëtar, trafikimi përbën shkelje të rëndë të të drejtave të njeriut dhe kërcënim ndaj demokracisë dhe sigurisë. Le të mendojmë për një çast për organizatat kriminale apo për grupet ekstremiste që fitojnë para prej kësaj “tregtie”

fitimprurëse, duke ushqyer korrupsionin, nënshtruar qytetarët, minuar qeverisjen dhe duke shtrembëruar konkurrencën në tregun e lirë.

Është e qartë se trafikimi i qenieve njerëzore nuk ka kursyer asnjë shtet, por disa shtete, - si Shqipëria për shembull, - kanë ndërmarrë hapa seriozë dhe veprime konkrete për ta luftuar atë. Në Vjenë, e kemi parë të gjithë se sa e suksesshme që Shqipëria gjatë Kryesimit të OSBE-së dhe besoj plotësisht se, edhe nga ulësja jo e përhershme në Këshillin e Sigurisë të Kombeve të Bashkuara, Tirana do të ofrojë kontribut të pazëvendësueshëm.

Masat kundër trafikimit janë të ngulitura në të gjitha përmasat politiko-ushtarake, ekonomike dhe mjedisore të OSBE-së, si në nivelin e Sekretariatit edhe në atë të misioneve.

Sa për bashkëpunimin me jashtë, OSBE-ja drejton një partneritet mjaft novator, *Aleancën kundër Trafikimit të Personave*, e cila organizoi konferencën e saj vjetore në nisje të kësaj jave, më datat 14-16 qershor. Konferenca e sotme vjen menjëherë pas të parës për të përdorur diskutimet e kësaj veprimtarie të rëndësishme të nivelit të lartë për të trajtuar sfidat në fushën e trafikimit të qenieve njerëzore në rajonin e OSBE-së.

OSBE-ja është mjaft e veçantë në trajtimin e trafikimit të qenieve njerëzore, falë angazhimeve të shumta të saj dhe të një plani veprimi të posaçëm, të cilat miratohen *me dakordësinë* e të gjitha Shteteve pjesëmarrëse të OSBE-së. Për këtë qëllim, ofrimi i ndihmës për institucionet shqiptare për t'i dhënë fund trafikimit të qenieve njerëzore përbën shtyllën mbajtëse të rolit tonë. Duke qenë kështu, ne u ofrojmë ekspertizë institucioneve shqiptare dhe shoqërisë civile për përmirësimin e kuadrit të politikave dhe atij institucional, për të forcuar mekanizmat e bashkërendimit ndërmjet institucioneve shoqërore, ligjzbatuese dhe gjyqësore, dhe për të përmirësuar aftësitë reaguese ndaj këtij fenomeni që zhvillohet vazhdimisht. Më lejoni të ndaj me ju një shembull se si ky partneritet është i ngulitur mirë në veprimtaritë tona. Me fonde nga Mbretëria e Bashkuar dhe në kuadër të një projekti të zbatuar me anë të zyrës së UNICEF-it në Shqipëri, - të cilat i falënderoj të dyja – ne do të prezantojmë një trajnim të veçantë në vjeshtë për institucione të shumta, duke përfshirë policinë, gjyqësorin, dhe shërbimet sociale, për hetimin e trafikimit të qenieve njerëzore në mënyrën e duhur. Ky trajnim në formë simulimi përbën një prej nismave pararendëse të OSBE-së për zhvillimin e kapaciteteve, të cilën Përfaqësuesi i Posaçëm Richey dhe ekipi i tij po na mbështesin fuqishëm ta zbatojmë për herë të parë në Shqipëri dhe në rajon.

2. Trafikimi i qenieve njerëzore është krim dhe shkelje e të drejtave të njeriut.

T'i japësh fund trafikimit të qenieve njerëzore do të thotë të mbrosh personat që bien pre e këtij trafikimi. Një raport i vitit 2020 i Zyrës së OKB-së për Drogën dhe Krimin vëren se “gjatë 15 viteve të fundit, numri i viktimave të diktuar është rritur”. Shumica dërrmuese e rasteve thjesht kalojnë pa u vënë re.

Më lejoni të theksoj admirimin që kam për strehëzat e viktimave të trafikimit, përfaqësues të cilave janë këtu sot dhe do të flasim për punën e tyre të paçmuar. Kam shkuar te njëra prej tyre dhe bashkëbisedimi me gratë e reja viktimat më ka lënë shenja që nuk fshihen. Edhe kjo është njëra prej arsyeve pse po organizohet konferenca e sotme.

Shqipëria ka një shembull të mrekullueshëm për drejtimin e *një bordi këshillimor për viktimat*, i cili u jep zë viktimave, të rritur e fëmijë, të trafikimit me secilin prej programeve të drejtuara

nga shteti apo nga partnerët që trajtojnë trafikimin e qenieve njerëzore. Është nismë e mrekullueshme t'u japësh viktimave një platformë që i bën të flasin me zërin e tyre.

Të gjithë jemi të ndërgjegjshëm për ndërlikimet e qenësishme të ndjekjes penale dhe dënimit në çështjet e trafikimit të qenieve njerëzore - dhe në këtë krim të posaçëm hetimet duhet të respektojnë të drejtat e viktimave në çdo fazë të procesit. Shqipëria ka ndërtuar një kuadër ligjor të fortë për kriminalizimin e trafikimit të qenieve njerëzore dhe për dënimin e keqbërësve. Në këtë kontekst, presim me padurim të dëgjojmë diskutimet përgjatë ditës së sotme dhe veçanërisht përshkrimin e gjyqtarit të Gjykatës së Lartë, z. Simoni, për rëndësinë e përqsasjes së qendëruar te viktima përgjatë ndjekjes penale dhe gjykimit të çështjeve të trafikimit të qenieve njerëzore.

3. Partneriteti në luftën ndaj trafikimit të qenieve njerëzore

Në fund, me lejoni të nënvizoj përsëri rëndësinë e bashkërendimit dhe partneritetit në këtë fushë. Roli i Bashkërenduesit Kombëtar është shumë i rëndësishëm për t'u siguruar që i tërë mekanizmi të jetë funksional dhe që përqsasja gjithëpërfshirëse të jetë realitet. Në këtë pikë, më lejoni të përgëzoj zëvendësministren Kuko, e cila është përgjegjëse për portofolin kundër trafikimit.

Po aq i rëndësishëm është roli i mekanizmave të mbikëqyrjes dhe presim me padurim të dëgjojmë se si Kuvendi i Shqipërisë e ka ushtruar këtë funksion. Znj. Gjebrea, jemi mirënjohës që jeni sot këtu për të ndarë përvojën tuaj si ish-Koordinatorë Kombëtarë dhe si anëtarë e Kuvendit.

Edhe sektori privat duhet të jetë pjesë e këtij diskutimi, për t'u siguruar se hallkat e furnizimit nuk strehojnë punë të detyruar. Ne kemi nevojë edhe për bashkëpunimin e sektorit të financave, për të ndërprerë kalimet e paligjshme të parave që lidhen me trafikimin e qenieve njerëzore.

Thënë thjesht, duhet të ndërrojmë marsh, të investojmë më shumë energji në këtë luftë, ta ngremë atë në majë të programit politik dhe jam i sigurt se kështu rezultatet nuk do të mungojnë.

Është luftë për epërsinë e shtetit të së drejtës dhe është luftë me karakter etik. Duhet të mësojmë nga e shkuara, të përdorim të tashmen dhe të shikojmë drejt së ardhmes duke përqsafuar mjetet novatore.

Faleminderit!

Fund